

Fakte mbi Aktivitetin Filantropik

Tetor 2016

Partnerët Shqipëri, si pjesë e misionit të saj në mbështetje të sektorit jo-fitimprurës në Shqipëri dhe forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial, po punon për zhvillimin e filantropisë në vend. PSH ka realizuar:

- një seri studimesh mbi nivelin e zhvillimit të filantropisë në vend (**Sipërmarrja dhe Filantropia-Raport i Studimit, Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri, Raporti i monitorimit të aktivitetit filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2015**),
- ndërhyrje afatgjata që synojnë evidentimin e këtij aktiviteti nga ana e sektorit të biznesit (**Çmimi i Filantropisë**),
- krijimin e platformave që sjellin më pranë biznesin me nisma që promovojnë

përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik lokal (**Konkursi i Ideve të Gjelbërta**).


Për të dytin vit radhazi Partnerët Shqipëri po kryen monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike.

Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve. Ato vijnë në formën e informacionit të përmbledhur mujor që synon të ndihmojë në kuptimin dhe evidentimin e këtij aktiviteti.


Mbledhja e të dhënave mbështetet nga Catalyst

Gjatë muajit Tetor 2016 vlera e dhurimit të raportuar në nivel vendi është 5,900,000 Lekë, sipas të dhënave të mëposhtme.


Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës së Dhuruesve




Numri i Dhuruesve¹




Përfituesit




Shtrirja Gjeografike e Përfituesve



Fushat e Dhurimit



Kanalet e Dhurimit



Nga monitorimi për muajin Tetor 2016 të gjithë dhurimet e identifikuar nga Partnerët Shqipëri janë kryer në **Para** dhe vendndodhja e të gjithë donatorëve është në **Tiranë**.

¹Për hater të kësaj analize dhuruesit llogariten vetëm një herë pavarësisht numrit të dhurimeve të kryera gjatë periudhës së monitoruar

²Persona me aftësi të kufizuar